

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.515/19

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICËS-departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Gezim Ademi, dhe procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, ne lenden penale ndaj te pandehurit: E.I nga ... rr. ..., për shkak te veprës penale; Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhje me par. 6 dhe 1 KPRK-se, sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.II.nr.5003/18 te datës 24.01.2019, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te dt. 18.06.2019, ne mungesë te prokurorit e në prezencë te av. G.I e te pandehurit E.I me datën 19.06.2019, publikisht shpall, ndërsa me dt. 28.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: E.I, nga i ati I., e ëma D., e vajzërisë O., i lindur me dt. ... i në ... ku edhe jeton në rr. "...", me numër personal ..., i pa pune, i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i pa dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë vepër tjetër penale, Shqiptar, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt. 09.12.2018 rreth orës 07:35 në rrugën “...” te ura e ... – ..., duke iu përmbajtur dispozitave te nenit 231.1 dhe nenit 53.1 te Ligjit për Rregullat e komunikacionit rrugor, duke konsideruar ne mënyrë te shkujdesur se deri te aksidenti i trafikut nuk do te vije ose se do te mund ta shmang, ne atë mënyrë qe e ka drejtuar automjetin e tij kombi te markës “VW” me tab. Regj. ..., nga drejtimi i ... kah qendra e qytetit, dhe me këtë rast nuk e ka përshtatur shpejtësinë ndaj kushteve dhe gjendjes se rrugës, sepse ka pasur ngrica ne rruge, e ka humb kontrollin ndaj automjetit, ashtu qe ka dal ne traken e kundërt jashtë rrugës, dhe me pjesën e parme te majte te automjetit, godet rrethojën e metalte te urës, sillet, e pastaj vazhdon rrugën ne drejtim te ..., ku pjesën e parme anësore te automjetit del ne tretuar nga ana e majte e drejtimit te lëvizjes, ku i godet këmbësoret- te dëmtuarit F.O dhe R.O, te cilët kane qene ne tretuar duke ecur ne drejtim te qendrës se qytetit, e pastaj përsëri kthehet ne rruge ne traken e kundërt ku me pjesën e parme te majtë te automjetit godet ne automjetin e markës “Peugeot”, ne pjesën e parme te majtë te automjetit, me te cilën ka drejtuar i dëmtuari E.T, i cili ka qarkulluar ne drejtimin e kundërt, nga qendra ne drejtim te Shipolit, me c rast e dëmtuara F.O ka pësuar lëndime vdekjeprurëse, te cilat janë konstatuar ne shtëpinë e shëndetit ne ..., e i dëmtuari R.O ka pësuar lëndime te renda trupore te cilat paraqesim trauma te shumëfishta me gjakderdhje ne cipat e buta te trurit, thyerje e ashtit te majtë pykor-muror te kafkës dhe thyerje e ashtit te “urezës” se majte, e lëndime ka pësuar edhe i pandehuri, ne automjete janë shkaktuar dëme materiale.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 ne lidhje me par 6 e 1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,23,41,45,73, dhe 378 par 9 ne lidhje me par 6 e 1 te KPRK-se, dhe nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës e:

G J Y K O N

ME DENIM BURU ne kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar ne paraburgim nga data 09.12.2018, e deri me datën 08.01.2019, si dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga data 08.01.2019 deri me 07.02.2019, i llogaritet ne dënimin e shqiptuar.

Obligohet i akuzuari qe t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjekoligjor shumen prej 20€, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 51.10€ ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimit, shumen prej 30 euro, dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 30 euro, të gjitha këto është i obliguar qe t'i paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

Ne bazë te nenit 62 te KPK-ës, gjykata te pandehurit se bashku me dënim kryesorë i shqiptohen edhe:

Dënimin plotësues-Ndalimi i drejtimit te automjetit

Të pandehurit E.I gjykata ia ndalon drejtimin e automjetit për te gjitha kategoritë për periudhën kohore prej 2 vitesh, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi. koha e kaluar ne burg nuk llogaritet ne kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice - ka ngritur aktakuze PP.II.nr.5003/1118 te datës 24.01.2019, kundër të pandehurit E.I nga ... rr. ..., për shkak te veprës penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhje me par. 6 dhe 1 KPRK-se. Kjo qeshtje penale sipas vendimit te gjykatës se Apelit PA1.nr.290/2019, i datës 25.04.2019, është kthyer ne rigjykim, ngase ne shkresat e lendes ka munguar aktgjykimi burimor-shpallja e aktgjykimit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë duke theksuar se e ndjen veten fajtor për veprën penale që ju vihet në barrë njëkohësisht i vjen shume keq për rastin qe ka ndodhur dhe njëherit i premtton gjykatës se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra penale te ngjashme apo ndonjë vepër tjetër penale.

Prokurori lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar: konsideroj se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e gjykatës meqenëse i njëjti pranimin e fajësisë e ka dhënë ne mënyre vullnetare pa presion, dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tije dhe ky pranim i fajësisë është ne përputhje me gjendjen faktike, dhe me provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes, si dhe me kualifikimin ligjore te veprës penale, dhe njëherit i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, qe te pandehurin ta shpall fajtor, dhe ta gjykoj sipas ligjit, duke marre parasysh te gjitha rrethanat lehtësues dhe renduese, ti ketë parasysh pasojën e veprës penale qe ne rastin konkret ka pësuar një person me fatalitet dhe personi tjetër me lëndime te renda trupore.

Mbrojtësi i te pandehurit Av. G.I lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: i pandehuri e ka kuptuar te gjitha pasojat e pranimit te fajësisë, natyrën e saj si dhe i njëjti me vullnetin e tij te lire dhe pase konsultimit te mjaftueshëm me avokatin, e ka pranuar se e ka kryer veprën penale ne fjale. Njëkohësisht i propozoi gjykatës qe me rastin e dënimit te këtë parasysh rrethanat lehtësuese, siç janë pranimi i fajësisë mosha e re bashkëpunimi i te njëjtit me policin me gjykatën pastaj rrethanat personale ku i njëjti ne periudhën pas një muaji ka planifikuar te lidhe fejëse dhe te bej planifikim familjar i njëjti nuk ka qene i dënuar asnjëherë me pare, njëherit kërkon qe te merret edhe mendimi i Prokurorit sa i përket çështjes se dënimit. Prokurori lidhur me këtë deklaroi: pranimi i fajësisë te merret si rrethanë lehtësuese dhe njëherit nuk mund te harrojmë pasojat qe janë shkaktuar me rastin e aksidentit.

Mbrojtësi i te dëmtuarve L.O.1 dhe L.O.2 av. L.A deklaroi se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, megjithatë kërkoj nga ana e gjykatës q çdo prove te kësejë lende ta çmoj rrënjësisht duke ardhur teke e vërteta, ndërsa me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit gjykata te ketë parasysh demete e shkaktuara nga ana e te pandehurit si dhe rrethanat e veçanta te këtij rasti. Kësaj gjykata ia dorëzoi disa raporte mjekësore për te lënduarin R.O i cili qe nga dita e aksidentit e deri ne ditët e sotme është ne kujdes te vazhdueshëm nga ana e mjekëve dhe e familjareve me kujdes te shtuar dhe te domosdoshëm.

I dëmtuari L.O.2 lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaroi: i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit e me rastin e shqiptimit te dënimit gjykata ta shqiptoj dënimin sa me te larte ngase nena ime ka vdekur dhe babai ka pësuar lëndime te renda trupore.

I dëmtuari I.O lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaroi: i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit e me rastin e shqiptimit te dënimit gjykata ta shqiptoj një dënim ma te rende nga se familja ime është shkatërruar dhe se duhet përkujdesje e vazhdueshme ndaj R.O, i cili ka pësuar lëndime te renda trupore dhe se reja ime e ndjere ka vdekur.

I dëmtuari A.H lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaroi: i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, e me rastin e shqiptimit te dënimit gjykata ta shqiptoj një dënim me te rende nga se çdo dite ne Kosove po ndodhin raste me fatalitet si pasoj e aksidenteve rrugore.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi i pandehuri kuptoj natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bëri në mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike qe do të bënin të pamundur që gjykata të beje vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, e që konkretisht mbështetet ne provat materiale si; Raporti policor nr. ... i datës 09.12.2018, Raportet i mjekut specialist, raportin nga autopsia e te ndjerës F.O , konstatimin dhe mendimin e ekspertit mbi llojet dhe seriozitetin e lëndimeve te dt. 22.12.2018, konstatimi dhe mendimi i ekspertit te trafikut te dt. 19.12.2018, foto-dokumentacionin dhe skicën e vendit te ngjarjes, konstatimin e kontrollit te jashtëzakonshëm teknik te automjetit te dt. 10.12.2018, raporti mjekësor nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës i dt. 01.02.2019, raporti mjekësor me nr te protokollit ..., i datës 09.12.2018, të gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes së akuzës njëkohësisht janë me përputhjen me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke u bazuar ne nenin 73 te KPRK-se, ashtu qe kjo gjykatë pate parasysh lartasin e dënimit qe për këtë vepër penale minimumi i dënimit është 1 vit ndërsa maksimumi i dënimit për këtë vepër penale është 8 vite, po ashtu gjykata si rrethanë rënduese gjeti faktin se ne këtë aksident trafiku një person ka humbur jetën, dhe se personi tjetër ka pësuar lëndime te renda trupore, se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshimet primare te te pandehurit, se i njëjti ka lëviz me shpejtësi te madhe dhe ka qene pa patentë shofer, kryerja e veprave penale te kësaj natyre janë ne rritje e sipër, ndërsa në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin së i njëjti gjate shqyrtimit fillestar e pranoje në tersi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej ne barre me çka gjykatës i ndihmoje ne mase te madhe ne vërtetimin e drejt te gjendjes faktike, se veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, se i njëjti ka ra ndesh për here te par me ligjin. andaj gjykata duke u bazuar ne rrethanat e cekura si me lart te pandehurit i shqiptoje dënim si ne dispozitiv te aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Po ashtu Gjukata e ka llogaritur Kohen e kaluar ne paraburgim dhe ne arrest shtëpiak ne dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi duke llogaritur qe nga dt. 09.12.2018, e deri me datën 08.01.2019, kohen e kaluar ne paraburgim, si dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga data 08.01.2019 deri me 07.02.2019,

Gjukata ne baze te nenit 62 par.2 nen par 2.2 te KPRK-ës te pandehurit krahas dënimit kryesor i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues –ndalimin e drejtimit te automjetit dhe te njëjtit gjykata ia ndalon drejtimin e automjetit për te gjitha kategoritë për periudhën kohore prej 2 vitesh, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi me kusht që koha e kaluar ne burg të mos llogaritet ne kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues, ngase i njëjti ka kryer vepër të rend penale duke shkaktuar vdekjen e një personi dhe lëndime te renda trupore për te dëmtuarin tjetër, dhe se gjykata konstaton se pjesëmarrja e tij ne trafikun publik edhe për një kohë është e rrezikshme për sigurinë publike për shkak të paaftësisë se tij për drejtimin e sigurt të automjetit

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi qe për ekspertizën mjeko-ligjor shumen prej 20€, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 51.10€ ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimin vendosi për shumen prej 30 euro, si dhe për paushallin gjyqësor shumen prej 30 euro, të cilat është i obliguar qe t'i paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.515/2019 dt.28.06.2019

Procesmbajtësja:
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari:
Gezim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ankesë në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë- nëpërmes kësaj gjykate.